

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aksident i rëndë, alpinisti 28-vjeçar humb jetën pas rënies nga 60 metra - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/aksident-i-rende-alpinisti-28-vjecar-humb-jeten-pas-renies-nga-60-metra/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 19:44:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	19220bc02b67555bd951bafb1bff1b876b79b5b792c0ff8544046f704b6cb0b7
TEKSTI	f937f55b2c6b40d1b4e89dde6e0644f335d4468cb7be55995a4bbd4eb6b2c6b8
PAMJA	67912bf3fdd31e6bb44b639073f9676f0c4fac264a1101541e2228e74525f75b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fd40f5b13d8de2cdf298265d8968fec533b26d60d4f9e37c892fde2a16bb243e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fd40f5b13d8de2cdf298265d8968fec533b26d60d4f9e37c892fde2a16bb243e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Aksident i rëndë, alpinisti 28-vjeçar humb jetën pas rënies nga 60 metra

LAJMET E FUNDIT

Demo

Aksident i rëndë, alpinisti 28-vjeçar humb jetën pas rënies nga 60 metra

SEPTEMBER 25, 2026



Një alpinist britanik 28-vjeçar ka humbur jetën në Spanjë, pasi ka rënë rreth 60 metra nga një prej majave më të larta në veri të vendit.

Aksidenti ndodhi të enjten në Torrecerredo, në Malet Cantabria, pjesë e masivit të Picos de Europa. Sipas Gardës Civile Spanjolle, alpinisti ra në një përrua teksa po zbriste nga maja e malit.

Shërbimet e emergjencës u njoftuan rreth orës 13:27 me orën lokale, pas raportimit se një person kishte rënë në faqen lindore të malit. Në vendngjarje u dërguan një grup shpëtimi dhe një helikopter mjekësor.

Një mjek që ndodhej në ekip konfirmoi vdekjen e alpinistit rreth orës 14:18 dhe qëndroi në vendngjarje për të ruajtur trupin, deri në mbërritjen e një helikopteri të Gardës Civile, rreth një orë e 20 minuta më vonë.

Më pas, specialistët e shpëtimit malor u ulën me vinç në zonën e aksidentit, ku nxorën trupin e viktimës dhe sendet e tij personale.

Identiteti i alpinistit nuk është bërë publik. Autoritetet spanjolle kanë konfirmuar se ai ishte anglez dhe se ndodhej rreth 20 metra larg majës së Torrecerredo kur ndodhi aksidenti.

Trupi është transportuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Asturias, ku do t'i nënshtrohet procedurave përkatëse mjeko-ligjore.

Edhe Ministria e Jashtme britanike konfirmoi se ishte në kontakt me autoritetet lokale pas raportimeve për vdekjen e një shtetasi britanik në Spanjë.

Torrecerredo, me një lartësi prej rreth 2,650 metrash, ndodhet në zonën e Picos de Europa, një destinacion i njohur për alpinistët dhe turistët që praktikojnë ecjen malore.

Autoritetet lokale të turizmit e cilësojnë itinerarin për ngjitjen e Torrecerredos si "shumë të vështirë", duke paralajmëruar për terrenin e pjerrët dhe të ekspozuar, veçanërisht në pjesët e sipërme gjatë zbritjes.

spanjë

SHARE.

Postimet e reja

Aksident i rëndë, alpinisti 28-vjeçar humb jetën pa...

SEPTEMBER 25, 2026

Rama në OKB: Algoritmi krijoi narrativën e trillua...

SEPTEMBER 25, 2026

Tensione në qiell/ Avionët suedezë dhe finlandezë...

SEPTEMBER 25, 2026

Zjarr i madh në bazën ushtarake britanike, një...

SEPTEMBER 25, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonaajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.